



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija - Ministry of Industry,
Entrepreneurship, Trade and Innovation

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

Thirrje publike për aplikim në standin shtetëror të Kosovës në panairin Hannover Messe 2026

20 - 24 prill 2026
Adresa: Hanover, Gjermani

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese kosovare të sektorit të Teknologjisë Informative (TIK) dhe sektorit të Përpunimit të Metalit, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset prodhuese të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e standit, regjistrimin e 10 subjekteve pjesëmarrëse (5 prej tyre nga sektori i TIK-ut; dhe 5 prej sektorit të përpunimit të metalit (2 prej tyre Start-up (0-5 vjet)), shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimit të materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse. Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 02.04.2026. Dokumentet e plotësuara si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës (kërkohet: certifikata e regjistrimit me informatat mbi biznesin);
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
4. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);

5. Deklaratën nën betim;
6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 dhe apo 2025 nga Administrata Tatimore e Kosovës (kërkohet: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kriterëve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të përzgjidhen 10 subjekte, nëse aplikojnë më shumë subjekte të përgjegjshme do të përpilohet edhe lista rezervë në mënyrë që të zëvendësohet sipas vlerësimit nëse ndonjëra kompani tërhiqet për çfarëdo arsye, gjithashtu nëse nga njeri sektor nuk ka aplikacione të mjaftueshme dhe nga sektori tjetër ka më shumë aplikacione të përgjegjshme do të plotësohet lista nga sektori tjetër.

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
 - 1 pikë për 1 produkt
 - 3 pikë për 2 produkte
 - 5 pikë për 3 produkte
 - 7 pikë për 4 produkte dhe
 - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 5 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 4 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë vitit 2025, maksimum 10 pikë:
 - Shtetet e BE-së 5 pikë
 - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
 - Shtetet tjera 2 pikë.

- Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:
 - ISO 3 pikë dhe
 - Certifikime tjera 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panair apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
 - 1 deri në 3 panair 3 pikë dhe
 - 4 deri në 6 panair 5 pikë.
- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2024 dhe apo 2025, maksimumi 10 pikë:
 - 0 - 500.000 euro 4 pikë
 - 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
 - > 1,000.000 euro 10 pikë.
- Qarkullimi për kompanitë Start-up (0-5 vjet), qarkullimi i subjektit aplikues në vitin 2024 dhe apo 2025, maksimumi 10 pikë:
 - 0 - 50.00 euro 4 pikë
 - 50.01 – 5,000 euro 8 pikë dhe
 - > 5,000 euro 10 pikë;

Më 23.03.2026, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 02.04.2026 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe dokumentacioni për aplikim mund të merren në MINTI-KIESA apo të shkarkohen nga faqet e internetit: mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net